



GREENBRIDGE - Programi i Lëndës

Kursi mbi Aftësitë e Gjelbra - 1.3 Aftësi të Gjelbra për Zhvillim të Qëndrueshëm

Përshkrimi i përgjithshëm i kursit

Ky kurs i pajis edukatorët e arsimit profesional (VET) me njohuritë dhe mjetet e nevojshme për të identifikuar, mësuar dhe integruar aftësitë e gjelbra në programet e trajnimit profesional. Aftësitë e gjelbra si efienca e energjisë, menaxhimi i mbetjeve, riciklimi, energjia e rinovueshme dhe prodhimi i qëndrueshëm po bëhen gjithnjë e më të rëndësishme teksa industrive u kërkohet të përshtaten me Marrëveshjen e Gjelbër Evropiane dhe tranzicionin e dyfishtë - atë të gjelbër dhe digjital.

Edhe pse interesimi i nxënësve për aftësitë e gjelbra është i lartë, njohuritë praktike mbeten të ulëta, ndërkohë që punëdhënësit në gjithë Ballkanin Perëndimor theksojnë mospërputhjen midis kurrikulave profesionale dhe nevojave të tregut të punës. Ky kurs adreson pikërisht këtë boshllëk, duke i përgatitur edukatorët që të përfshijnë kompetencat e gjelbra në procesin e mësimdhënies, të harmonizojnë trajnimin me kërkesat e punëdhënësve dhe të motivojnë nxënësit të ndjekin karriera të qëndrueshme.

Rezultatet e të nxënit

Në përfundim të kursit, edukatorët do të jenë në gjendje të:

1. Identifikojnë aftësitë kryesore të gjelbra të rëndësishme për sektorë të ndryshëm të tregut të punës.
2. Shpjegojnë rëndësinë e aftësive të gjelbra për zhvillimin e qëndrueshëm dhe tranzicionin e dyfishtë.
3. Integrojnë aftësitë e gjelbra në programet profesionale dhe në praktikat e përditshme të mësimdhënies.



4. Përdorin studime rasti për të ilustruar zbatimin e suksesshëm të aftësive të gjelbra në tregun e punës.

5. Zhvillojnë strategji mësimdhënieje që rrisin ndërgjegjësimin, motivimin dhe vetëbesimin e nxënësve për të aplikuar aftësitë e gjelbra.

Struktura dhe përmbajtja e kursit

Moduli 1: Identifikimi i aftësive thelbësore të gjelbra në tregun e punës

Qëllimi i modulit është të ndërtojë mirëkuptimin e edukatorëve mbi konceptin e aftësive të gjelbra dhe rëndësinë e tyre. Moduli shpjegon dallimin midis aftësive sektoriale (p.sh. energji e rinovueshme, eko-ndërtim) dhe aftësive ndër-sektoriale (p.sh. efienca e burimeve). Ai eksploron transformimet që aftësitë e gjelbra po sjellin në industri si efienca energjetike, menaxhimi i mbetjeve, riciklimi, energjia e rinovueshme dhe prodhimi i qëndrueshëm.

Gjithashtu shqyrtohen nevojat e tregut të punës në nivel lokal dhe pritshmëritë e punëdhënësve. Prezantohen metoda për monitorimin e trendeve të reja, konsultimet me punëdhënësit dhe lidhja e aftësive të gjelbra me lëndët profesionale. Korniza Evropiane e Kompetencave të Qëndrueshmërisë (GreenComp) paraqitet si referencë kryesore për integrimin e aftësive të gjelbra.

Nëntitujt:

1.1. Përkufizimi i aftësive të gjelbra

1.2. Tendencat e tregut të punës dhe kërkesat për aftësi të gjelbra në Ballkanin Perëndimor

1.3. Roli i mësimdhënësve në identifikimin e aftësive

Moduli 2: Integrimi i aftësive të gjelbra në arsimin profesional

Qëllimi i modulit është të sigurojë mjete praktike për integrimin e aftësive të gjelbra në mësimdhënie. Ky modul prezanton strategji për përfshirjen e kompetencave të gjelbra në lëndët ekzistuese pa shtuar ngarkesë mësimore, duke u fokusuar te mësimi përmes përvojës dhe metodave aktive: projektet praktike, simulimet, detyrat e zgjidhjes së problemeve.

Moduli shqyrton rolin e mjeteve digjitale në përkrahjen e qëndrueshmërisë në VET. Ofron qasje praktike për tejkalimin e sfidave të zakonshme si mungesa e materialeve, nevoja për trajnim të mësuesve dhe keqkuptimet e nxënësve. Temat kyçe përfshijnë eficiencën energjetike, menaxhimin e mbetjeve, riciklimin, energjitë e rinovueshme dhe prodhimin e qëndrueshëm.



Nëntitujt:

- 2.1. Integrimi në kurrikulë, qasjet dhe metodologjitë e mësimdhënies
- 2.2. Sinergjitë mes aftësive të gjelbra dhe atyre digjitale
- 2.3. Kapërcimi i pengesave

Moduli 3: Studime rasti – zbatime të suksesshme të aftësive të gjelbra në tregun e punës

Ky modul demonstroi rëndësinë praktike të aftësive të gjelbra përmes shembujve konkretë. Fokusi është në fusha si efienca energjetike, menaxhimi i mbetjeve, riciklimi, energjitë e rinovueshme dhe prodhimi i qëndrueshëm. Edukatorët njihen me profesionet e reja që po shfaqen në këto sektorë dhe me studime rasti të aplikimit në praktikë.

Nëntitujt:

- 3.1. Profesionet e reja të gjelbra në fushat kryesore të qëndrueshmërisë
- 3.2. Studime sektoriale rasti
- 3.3. Projektet e nxënësve për të nxitur të nxënit praktik

Aktivitete mësimore dhe metodat e të nxënit

- Mësim vetanak online me materiale të përgatitura (tekst, ilustrime dhe video të gjeneruara me vegla nga Inteligjenca Artificiale)
- Sesione me ligjëruesit për prezantimin e materialit të ri
- Diskutime dhe trajnim interaktiv me ligjëruesin

Orari dhe kohëzgjatja e kursit

Moduli	Sesioni me ligjërues (fizik/online)	Mësimi i pavarur
Moduli 1	1 orë	30 min
Moduli 2	1 orë	30 min
Moduli 3	1 orë	30 min
Totali	3 orë	1 orë e 30 min

Metodat e vlerësimit

- Për secilin modul ofrohet një pyetësor vetëvlerësimi me pyetje me nga vetëm një përgjigje.